



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 8, Datë 21.07.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS DHE SHTËPIVE ZËVËNDËSUERE PËR FAMILJET QË PREKEN NGA PROGRAMI I RISISTEMIMIT TË ‘DEVOLL HYDRO-POWER’, NË KUADËR TË PROJEKTIT HIDROENERGJETIK TË DEVOLLIT”, ME VENDNDODHJE NË TERRITORIN E BASHKISË GRAMSH DHE BASHKISË CËRRIK,

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimin e infrastrukturës dhe shtëpive zëvendësuese për familjet që preken nga programi i risistemimit të ‘Devoll Hydro-power’, në kuadër të projektit hidroenergjetik të Devollit”, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Gramsh dhe Bashkisë Cërrik, dhe subjekt aplikues shoqërinë “Devoll Hydropower” Sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT